

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Nenit 12 paragrafit 3, nën-paragrafit 3.1 të Ligjit nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare nr. 1, 17 janar 2022), Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës miraton:

STATUTIN E ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOShME

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Statuti është akti më i lartë i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda).
2. Statuti ka për qëllim të rregulloj:
 - 2.1. natyrën dhe organizimin e punës së Odës dhe organeve të saj;
 - 2.2. selinë, logon dhe vulën e Odës;
 - 2.3. të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Odës;
 - 2.4. njësitë organizative dhe përfaqësitë e Odës;
 - 2.5. procedurën e nominimit, zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve në organet e Odës;
 - 2.6. procedurën e nxjerrjes dhe ndryshimit të akteve të Odës, dhe
 - 2.7. çështje të tjera të cilat e adresojnë funksionimin dhe ato që janë të rëndësishme për punën e Odës.
3. Ky Statut zbatohet për Odën, organet, anëtarët e saj dhe të gjithë personat të përmendur shprehimisht në këtë Statut.

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Statut kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji në fuqi).

2. Emrat në një të njërit gjini të përdorura në këtë Statut nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

KAPITULLI II

NATYRA DHE ORGANIZIMI I PUNËS SË ODËS

Neni 3

Natyra e punës së Odës

1. Oda është organizatë profesionale jofitimprurëse e cila ka për qëllim rregullimin e profesionit të inxhinierit, me qëllim ruajtjen e shëndetit, sigurisë publike dhe mbrojtjen e mjedisit.
2. Oda e ka statusin e personit juridik me autoritet publik për kryerjen e funksioneve të parapara me Ligjin në fuqi dhe aktet e miratuara nga Oda.
3. Puna e Odës është publike dhe i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për qasje në dokumentet publike. Të gjitha aktet e përgjithshme të Odës dhe aktet tjera publikohen në formë elektronike në web-faqen e saj.

Neni 4

Përfaqësimi i Odës

1. Oda përfaqëson dhe harmonizon interesat e përbashkëta të anëtarëve të Odës pranë institucioneve shtetërore dhe palëve tjera, brenda dhe jashtë vendit.
2. Oda përfaqësohet nga Kryetari i Odës ose përfaqësuesit tjerë të organeve të Odës, ose anëtarët e saj, të autorizuar nga Kryetari i Odës.

Neni 5

Emërtimi dhe selia

1. Emërtimi i Odës është "Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës", ndërsa në veprimtarinë e vet mund të përdoret shkurtesa "OIRK".
2. Selia e Odës është në Prishtinë, në vendin e përcaktuar nga Bordi Drejtues i Odës.
3. Me vendim të Kuvendit të Odës, mund të krijohen përfaqësi të tjera të Odës, pas periudhës së përkohshme të themelimit të Odës të përcaktuar me Ligjin në fuqi.

Neni 6

Logo dhe vula

1. Oda ka logon dhe vulën zyrtare, e cila përmban emërtimin dhe shkurtesën e Odës, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Forma e logos dhe vulës nga paragrafi 1 përcaktohet me vendim të Bordit Drejtues të Odës.

Neni 7
Dita e Inxhinierëve

Oda shënon ditën botërore të inxhinierëve, më 4 Mars të çdo viti.

KAPITULLI III
KOMPETENCAT E ODËS

Neni 8
Kompetencat dhe detyrat e Odës

1. Kompetencat themelore të Odës sipas Ligjit në fuqi janë:
 - 1.1. Licencimi i inxhinierëve;
 - 1.2. Përpilimi dhe mirëmbajtja e regjistrave të Odës;
 - 1.3. Vendosja dhe mbikëqyrja e standardeve dhe etikës së punës së inxhinierëve në pajtim me Statutin, Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale dhe aktet e tjera të Odës;
 - 1.4. Përfaqësimi i interesave të profesionit gjatë zhvillimit të politikave nga organet Qeveritare, duke i mbështetur inxhinierët nëpërmjet avokimit për të drejtat e tyre si dhe për interesin profesional, ekonomik dhe social të tyre;
 - 1.5. Mbrojtja e reputacionit të profesionit të inxhinierit;
 - 1.6. Përcaktimi i përgjegjësiwe profesionale dhe disiplinore për anëtarët e licencuar, dhe
 - 1.7. Organizimi i edukimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional për anëtarët e licencuar.
2. Me qëllim të arritjes së objektivave të saj, Oda kryen edhe detyra të tjera si në vijim:
 - 2.1. Bashkëpunon me Ministrinë përgjegjëse për planifikim hapësinor dhe ndërtim dhe institucionet tjera shtetërore në hartimin e legjislacionit në fushën e planifikimit hapësinor, ndërtimit, mbrojtjes së mjedisit dhe fushave tjera që ndërlidhen me punën e inxhinierit, si dhe merr iniciativa për ndryshime legjislative në këto fusha;
 - 2.2. Ofron mbështetje profesionale për anëtarët e Odës;
 - 2.3. Promovon të drejtat e autorit dhe interesat tjera legjitime të anëtarëve të Odës;

- 2.4. Organizon mbajtjen e ekspozitave, punëtorive apo ligjëratave për inxhinierinë dhe kontribuon në zhvillimin e standardeve për arsimin e lartë dhe programeve mësimore universitare, me qëllim të ngritjes së cilësisë së tyre;
- 2.5. Monitoron dhe studion gjendjen e fushës së ndërtimit, si dhe zhvillon standarde për të ngritur cilësinë në ushtrimin e profesionit të inxhinierit;
- 2.6. Përgatit raporte për Ministrinë përgjegjëse për planifikim hapësinor dhe ndërtim dhe organet tjera shtetërore, me vetiniciativë ose sipas kërkesës së tyre, për gjendjen, problemet dhe masat që duhen ndërmarrë për të përmirësuar planifikimin hapësinor dhe ndërtimin;
- 2.7. Bashkëpunon me Odën e Arkitektëve të Republikës së Kosovës dhe institucionet, organet e shoqatave tjera profesionale, vendore dhe ndërkombëtare;
- 2.8. Organizon konkurse në fushën e inxhinierisë dhe ofron ndihmë profesionale për klientët në zhvillimin e projekteve, në rastet kur kjo kërkohet nga Oda;
- 2.9. Ofron shërbime profesionale në përputhje me misionin dhe legjislacionin në fuqi;
- 2.10. Ndan çmime dhe mirënjohje për anëtarët e Odës të cilët vlerësohen për cilësinë e tyre të punës dhe sjelljen profesionale, si dhe çmime tjera për promovimin e cilësisë së ndërtimit, dhe
- 2.11. Çfarëdo detyre tjetër në fushën e inxhinierisë që është në përputhje me misionin dhe natyrën e punës së Odës.

KAPITULLI IV ANËTARËSIA E ODËS

Neni 9 Anëtarët e Odës

1. Të gjithë inxhinierët e licencuar nga Oda sipas kategorive përkatëse A dhe B në pajtim me Ligjin në fuqi dhe rregulloren përkatëse për licencim, janë anëtarë të rregullt të Odës.
2. Përveç inxhinierëve të licencuar, anëtarë jo të rregullt të Odës, janë edhe kategoritë në vijim:
 - 2.1. Anëtar praktikant;
 - 2.2. Anëtar student;
 - 2.3. Anëtar i pensionuar;
 - 2.4. Anëtar nderi;

- 2.5. Anëtar i asociuar, dhe
 - 2.6. anëtarë të tjerë, të përcaktuar me vendim të Kuvendit të Odës.
3. Të drejtën e anëtarësisë si anëtar praktikant në Odë e kanë praktikantët të cilët zhvillojnë punë praktike në profesionin e inxhinierisë, pas diplomimit, me synim licencimin nga Oda. Kjo e drejtë fitohet me regjistrim të punës praktike në Odë.
 4. Puna praktike nga paragrafi 3 zhvillohet në mbikëqyrjen e anëtarit të rregullt të Odës. Oda lëshon vërtetimin për përfundimin e punës praktike, pas konfirmimit nga mbikëqyrësi i praktikantit.
 5. Për qëllime të zbatimit të paragrafit 3 dhe 4, Oda miraton Rregulloren për regjistrimin, të drejtat dhe detyrimet e praktikantëve në fushën e inxhinierisë.
 6. Të drejtën e anëtarësisë si anëtar student në Odë e kanë studentët e fushës së inxhinierisë, deri në diplomimin e tyre. Kjo e drejtë fitohet me regjistrim të tyre në Odë.
 7. Të drejtën e anëtarësisë si anëtar i pensionuar në Odë e kanë anëtarët e rregullt të Odës të cilët e revokojnë licencën, me kërkesën e tyre, për arsye të pensionimit nga profesioni i inxhinierit.
 8. Anëtarët tjerë jo të rregullt të Odës zgjedhën nga Kuvendi, pas propozimit të bërë nga organet e Odës apo një e treta (1/3) e anëtarëve të rregullt të Odës.
 9. Anëtarësia në Odë është me pagesë vetëm për anëtarët e rregullt të Odës nga paragrafi 1 i këtij Neni.

Neni 10 **Të drejtat e anëtarëve të Odës**

1. Anëtarët e rregullt të Odës kanë të drejtë të:
 - 1.1. marrin pjesë në proceset zgjedhore të organeve të Odës, me të drejtë vote;
 - 1.2. zgjedhën në organet dhe komisionet e Odës të përcaktuara me Ligjin në fuqi, si dhe emërohen në komisionet, këshillat dhe grupet tjera të punës të Odës;
 - 1.3. propozojnë ndryshimin apo miratimin e akteve nënligjore të reja, përmes organeve të Odës;
 - 1.4. marrin pjesë në shqyrtimet e propozimeve të ligjeve dhe akteve tjera të Qeverisë dhe nivelit lokal në fushën e ndërtimit, sipas autorizimit;
 - 1.5. propozojnë fillimin e procedurës disiplinore ndaj inxhinierit të licencuar;
 - 1.6. marrin pjesë në ngjarjet profesionale dhe shoqërore të organizuara nga Oda;

- 1.7. propozojnë dhe shqyrtojnë çështje nga fusha e inxhinierisë, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit;
 - 1.8. shfrytëzojnë shërbimet ligjore dhe profesionale të Odës;
 - 1.9. mbledhin dhe ofrojnë të dhëna të nevojshme për përfaqësimin dhe promovimin e interesave të përbashkëta të Odës;
 - 1.10. ofrojnë sugjerime për përmirësimin e punës së organeve të Odës dhe zhvillimin e Odës në përgjithësi, dhe
 - 1.11. të drejta tjera të përcaktuara me Ligjin në fuqi, këtë Statut apo aktet tjera të Odës.
2. Anëtarët jo të rregullt të Odës kanë të drejtat e përcaktuara nga nën-paragrafi 1.6 deri 1.11 të këtij Neni. Anëtari praktikant i Odës ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional të Odës, por pa fituar pikë kredituese.
3. Anëtarët jo të rregullt të Odës nuk janë pjesë e Kuvendit të Odës dhe organeve tjera vendim-marrëse të Odës dhe nuk kanë të drejtë vote.

Neni 11

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Odës

1. Anëtarët e rregullt të Odës kanë për detyrë dhe përgjegjësi që të:
- 1.1. zbatojnë dispozitat e Statutit, rregulloreve, vendimeve dhe akteve tjera të Odës;
 - 1.2. zhvillojnë veprimtarinë profesionale me ndërgjegje dhe në mënyrë etike në përputhje me Kodin e Etikës dhe ligjet në fuqi;
 - 1.3. ndjekin edukimin e vazhdueshëm profesional të Odës, në përputhje me Ligjin në fuqi dhe rregulloren përkatëse për edukimin e vazhdueshëm profesional të anëtarëve të Odës;
 - 1.4. respektojnë të drejtat e autorit;
 - 1.5. ofrojnë të dhëna dhe informata, me kërkesë të organit të Odës, lidhur me sjelljen dhe veprimtarinë e tyre profesionale në zbatim të standardeve dhe etikës së punës;
 - 1.6. informojnë rregullisht organet e Odës për të dhënat apo çfarëdo ndryshimi të të dhënave që kanë të bëjnë me licencën e tyre për ushtrimin e veprimtarisë;
 - 1.7. paguajnë me rregull tarifën e anëtarësimit dhe çdo pagesë tjetër përkatëse të përcaktuar nga organet e Odës;
 - 1.8. shmangin konfliktin e interesit, dhe

1.9. kryejnë detyrime tjera të përcaktuara me Ligjin në fuqi, këtë Statut apo aktet tjera të Odës.

2. Anëtarët jo të rregullt të Odës kanë për detyrë dhe përgjegjësi të veprojnë me ndërgjegje, etikë dhe në përputhje me rregullat e Odës, gjatë aktiviteteve të tyre.

3. Anëtari i Odës mban përgjegjësi disiplinore para Komisionit Disiplinor të Odës nëse me veprimin e tij ose mos-veprimin e tij në ushtrimin e veprimtarisë bën shkelje disiplinore, në përputhje me rregulloren përkatëse për procedurën disiplinore ndaj anëtarëve të Odës.

Neni 12

Pezullimi dhe revokimi i anëtarësisë në Odë

1. Pezullimi dhe revokimi i anëtarësisë së anëtarëve të rregullt të Odës përcaktohet me Ligjin në fuqi dhe rregulloren përkatëse për procedurën disiplinore ndaj anëtarëve të Odës.

2. Pezullimi dhe revokimi i anëtarësisë së anëtarëve jo të rregullt të Odës bëhet nga Bordi Drejtues i Odës për anëtarin praktikant, anëtarin student dhe anëtarin e pensionuar, ndërsa nga Kuvendi për anëtarin e nderit, anëtarin e asociuar dhe anëtarët tjerë jo të rregullt.

Neni 13

Regjistrat e Odës

1. Regjistrat e detyrueshëm që mbahen nga Oda përcaktohen me Ligjin në fuqi, ndërsa Oda mund të krijojë dhe mbajë regjistra të tjerë sipas nevojës.

2. Oda me Rregullore e përcakton përmbajtjen e regjistrave, mënyrën e regjistrimit, dhe mirëmbajtjes së tyre.

KAPITULLI V ORGANET E ODËS

Neni 14

Organet e Odës

1. Organet e Odës janë:

1.1. Kuvendi;

1.2. Kryetari;

1.3. Komisioni Mbikëqyrës;

1.4. Bordi Drejtues;

1.5. Komisioni Disiplinor;

1.6. Komisioni i Ankesave;

1.7. Drejtori Ekzekutiv; dhe

1.8. Administrata.

2. Anëtarët e Odës nuk mund të ushtrojnë në organet e Odës më shumë se një pozitë të zgjedhur nga Kuvendi përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin në fuqi. Para procedurës së zgjedhjeve, anëtarët e nominuar në dy apo më shumë organe përcaktohen për pozitën të cilën dëshirojnë ta ushtrojnë.

3. Kryetari dhe anëtarët e Bordit Drejtues si dhe anëtarët e komisioneve të përcaktuara sipas këtij neni nuk mund të mbajnë pozita udhëheqëse në organizata joqeveritare, publike apo politike.

4. Paragrafi 3 përfshin gjithashtu ndalesën që Kryetari dhe anëtarët e Bordit Drejtues si dhe anëtarët e komisioneve të përcaktuara sipas këtij neni, të jenë anëtar të një bordi apo themelues aktiv të një organizate joqeveritare, që mund të përbëjë konflikt interesi.

Neni 15 **Përbërja dhe kompetencat e Kuvendit**

1. Kuvendi i Odës është organi më i lartë i Odës dhe përbëhet nga anëtarët e rregullt të Odës.

2. Përgjegjësitë dhe kompetencat e Kuvendit janë:

2.1. Aprovimi dhe ndryshimi i Statutit të Odës, Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale, Rregulloreve të përcaktuara me Ligjin në fuqi dhe të akteve tjera të Odës të përcaktuara me këtë Statut;

2.2. Zgjedhja dhe shkarkimi i anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës, Bordit Drejtues, Komisionit Disiplinor dhe Komisionit të Ankesave;

2.3. Miratimi i buxhetit vjetor të Odës dhe i mënyrës së ekzekutimit të tij, në përputhje me kufizimet dhe detyrimet gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës;

2.4. Miratimi i shumave të kompensimit të anëtarëve të Organeve të Odës;

2.5. Miratimi i rregullores së taksave dhe tarifave si dhe mënyrës së pagesës së tyre;

2.6. Vlerësimi dhe miratimi i raporteve të organeve të Odës;

2.7. Krijimi i organeve të tjera të Odës sipas nevojës të parashikuar me Ligjin në fuqi dhe këtë Statut;

2.8. Krijimi i komisioneve tjera, grupeve punuese, këshillave profesional, grupeve të ekspertëve, me mandat të caktuar, për çështje në kompetencë të Kuvendit, dhe

2.9. Vendosja për çështjet tjera të parashikuara me Ligjin në fuqi dhe këtë Statut.

3. Në Kuvend mund të diskutohet për të gjitha çështjet tjera me interes të përbashkët të anëtarëve të Odës dhe çështje tjera të funksionimit dhe kompetencave të Odës. Për këto çështje Kuvendi mund të miratoj rezoluta dhe rekomandime.

Neni 16

Mbledhja e Kuvendit

1. Kuvendi mban mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

2. Mbledhjet e Kuvendit kryesohen nga Kryetari i Odës.

3. Bordi Drejtues i Odës thërret mbledhjet e rregullta të Kuvendit të paktën një (1) herë në vit.

4. Bordi Drejtues obligohet të thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit në rrethana të jashtëzakonshme në të cilat pikë e diskutimit është një apo më shumë çështje të natyrës urgjente.

5. Mbledhje të jashtëzakonshme mund të inicojë edhe një e treta (1/3) e anëtarësisë së Kuvendit, për të cilën Bordi Drejtues është i obliguar të thërras këtë mbledhje, që mbahet më së largu në afat prej njëzetënjë (21) ditë nga paraqitja e iniciativës.

6. Bordi Drejtues është i detyruar që përmes administratës t'i njoftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit, të paktën njëzetënjë (21) ditë para datës së caktuar për mbledhje të rregullt dhe të paktën dhjetë (10) ditë para datës së caktuar për mbledhje të jashtëzakonshme.

7. Në rast që Bordi Drejtues nuk e thërret mbledhjen sipas paragrafit 5, Kuvendi mblidhet sipas thirrjes së përfaqësuesit të një të tretës (1/3) së anëtarësisë së Kuvendit nga paragrafi 5.

8. Në mungesë të Kryetarit të Odës, mbledhja e Kuvendit kryesohet nga një anëtar tjetër i autorizuar i Bordit Drejtues, ndërsa në mungesë edhe të anëtarëve të Bordit Drejtues, atëherë Kuvendi kryesohet nga anëtari më i vjetër i Kuvendit.

9. Mbledhjet e Kuvendit mund të mbahen në më shumë se një ditë dhe në më shumë se një lokacion sipas nevojës.

10. Mbledhjet e Kuvendit mund të mbahen gjithashtu me pjesëmarrjen e anëtarëve nëpërmjet videokonferencës apo me mjete të tjera të përshtatshme të komunikimit në distancë.

11. Administrata e Odës kujdeset për njoftimin e të gjithë anëtarëve të Odës për diskutimet dhe vendimet e miratuara në Kuvendin e Odës.

Neni 17

Kuorumi dhe marrja e vendimeve nga Kuvendi

1. Kuvendi ka kuorum kur në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të licencuar të Odës.

2. Vendimet në Kuvend miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të rregullt të Odës që janë të pranishëm dhe që votojnë.

3. Votimin në mbledhjet e Kuvendit e bënë vetëm anëtari i pranishëm në Kuvend dhe nuk lejohet votimi me autorizim.

4. Në rastin e mbledhjeve nga paragrafi 10 i Nenit 16, votimi bëhet në formë elektronike nga distanca, vetëm nëse sistemi elektronik siguron votimin e fshehtë, në rastet kur kjo kërkohet sipas këtij Statuti.

5. Vendimet e Kuvendit janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët dhe organet e Odës.

Neni 18

Rregullorja e punës së Kuvendit

Mënyra e punës dhe funksionimit të Kuvendit mund të përcaktohet në mënyrë më të hollësishme me Rregullore të Punës të miratuar nga Kuvendi.

Neni 19

Nominimi dhe zgjedhjet e organeve të Odës në Kuvend

1. Zgjedhjet për organet e Odës shpallen nga Kuvendi i Odës.

2. Secili anëtarë i rregullt i Odës që ka licencë të vlefshme, nuk ka të vendosur masë disiplinore për shkelje të rëndë dhe nuk është i dënuar për vepër penale, ka të drejtë të zgjidhet në organet e Odës në përputhje me procedurën dhe rregullat zgjedhore.

3. Nominimet për anëtarë të organeve të Odës mund të bëhen nga vetë kandidatët, anëtarët tjerë të rregullt të Odës apo organet e Odës. Këto nominime bëhen në periudhë prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga thirrja për nominime.

4. Bordi Drejtues shqyrton brenda afatit prej shtatë (7) ditë nominimet e pranuar dhe pranon ose refuzon ato në bazë të kriterëve të përcaktuara me këtë Statut. Pala e pakënaqur me vendimin e Bordit Drejtues, ka të drejtë ankesë në afat prej shtatë (7) ditë në Komisionin e Ankesave të Odës.
5. Komisioni i Ankesave shqyrton ankesat nga paragrafi 4 në afat prej shtatë (7) ditë.
6. Lista zgjedhore përfundimtare publikohet nga Bordi Drejtues, së paku shtatë (7) ditë para mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit për zgjedhjen e organeve të Odës. Nominimet në listën zgjedhore renditen sipas datës dhe kohës së nominimit apo duke filluar nga i nominuari i parë.
7. Kandidatura për nominim nuk do të jetë e vlefshme, deri sa kandidati i nominuar do ta jap pëlqimin e tij duke njoftuar Bordin Drejtues, përkitazi me nominimin i cili i është bërë.
8. Zgjedhjet mbahen në bazë të votës së lirë dhe të barabartë të anëtarëve të Kuvendit në përputhje me Ligjin në fuqi dhe Statutin e Odës. Votimi është i fshehtë.
9. Për zgjedhjen e anëtarëve të organeve të Odës aplikohet procedurë e veçantë organizative dhe zgjidhet lokacioni i përshtatshëm për organizimin e votimit.
10. Çdo anëtar me të drejtë vote ka të drejtë të votoj nga një të nominuar në secilën kategori për zgjedhje në organet e Odës.
11. Kur kandidatët kanë vota të barabarta dhe nuk mund të plotësohet numri i anëtarëve në organet e Odës, zhvillohet një raund i dytë i votimit, dhe raunde pasuese të votimit nëse është e nevojshme, për ata kandidatë që kanë numër të barabartë të votave për të plotësuar numrin e anëtarëve në organet e Odës.

Neni 20

Zgjedhja dhe shkarkimi i Kryetarit të Odës

1. Kryetari i Odës zgjidhet nga Bordi Drejtues nga radha e anëtarëve të vet.
2. Kryetari i Odës zgjidhet në mbledhjen e parë të Bordit Drejtues dhe me shumicë të votave të të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues.
3. Anëtarët e zgjedhur të Bordit Drejtues gjatë votimit për Kryetar të Bordit, nuk mund ta votojnë vetveten.
4. Në rast të votave të barabarta, zhvillohet një raund i dytë i votimit, dhe raunde pasuese të votimit nëse është e nevojshme, deri në zgjedhjen e Kryetarit të Odës.
5. Mandati i Kryetarit është tri (3) vjet, pa të drejtë rizgjedhje. Zgjedhja në pozitën e Kryetarit të Odës nuk e zgjat mandatin e anëtarit të Bordit Drejtues.

6. Kryetari i Odës mund të shkarkohet me shumicë të votave të të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues në rast të:

- 6.1. pezullimit apo revokimit të licencës;
- 6.2. vendosjes së masës disiplinore për shkelje të rëndë;
- 6.3. dënimit për vepër penale;
- 6.4. shkeljes së Statutit të Odës, ose
- 6.5. për arsye të neglizhencës apo mos efikasitetit të punës së tij në zbatim të Programit të Odës.

7. Vendimi për shkarkim arsyetohet.

8. Në rast të shkarkimit të Kryetarit të Odës, Bordi Drejtues zgjedh Kryetarin e ri për pjesën e mbetur të mandatit, në mbledhjen e parë të radhës.

Neni 21

Kompetencat e Kryetarit të Odës

1. Kryetari është kompetent dhe përgjegjës për:

- 1.1. Përfaqësimin e Odës;
- 1.2. Nënshkrimin e marrëveshjeve në emër të Odës;
- 1.3. Implementimin e vendimeve të organeve të Odës kur parashihet me Statut;
- 1.4. Thirrjen e takimeve të Bordit Drejtues;
- 1.5. Kryesimin e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Bordit Drejtues;
- 1.6. Nënshkrimin e licencave;
- 1.7. Koordinimin dhe harmonizimin e aktiviteteve të organeve të Odës;
- 1.8. Autorizimin e shpenzimeve në kuadër të buxhetit të Odës, në përputhje me kufizimet dhe detyrimet gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës;
- 1.9. Autorizimin e përfaqësimit të Odës nga anëtarët tjerë dhe të udhëtimeve zyrtare që mbulohen nga buxheti i Odës;

- 1.10. Kryerjen e punëve tjera siç parashihen me këtë Statut.
2. Kryetari i Odës nënshkruan aktet e përgjithshme të Odës dhe aktet tjera të miratuara nga Kuvendi dhe Bordi Drejtues.
3. Kryetari i Odës i përgjigjet Kuvendit të Odës.
4. Në rast të pamundësisë së udhëheqjes së Bordit Drejtues apo mbledhjes së Kuvendit nga ana e Kryetarit të Odës, mbledhjet mund t'i udhëheqë ndonjë nga anëtarët tjerë të Bordit Drejtues, siç përcaktohet me këtë Statut.
5. Në rast të mungesës për shkaqe të arsyeshme, Kryetari i Odës autorizon një nga anëtarët e Bordit Drejtues për të zëvendësuar atë gjatë periudhës së mungesës së Kryetarit.

Neni 22

Komisioni Mbikëqyrës i Odës

1. Komisioni Mbikëqyrës i Odës përbëhet nga tre (3) anëtarë, dy (2) prej të cilëve zgjidhen nga Kuvendi i Odës dhe një (1) anëtar të cilin e cakton Ministria sipas detyrës zyrtare i cili njëkohësisht e ushtron funksionin e Kryesuesit të këtij Komisioni.
2. Mandati i anëtarit të Komisionit Mbikëqyrës të zgjedhur nga Kuvendi i Odës është tre (3) vjet, pa të drejtë rizgjedhje.
3. Komisioni Mbikëqyrës është kompetent dhe përgjegjës për:
 - 3.1. Kontrollin e ligjshmërisë së punës dhe veprimtarisë financiare të organeve të Odës;
 - 3.2. Përpilimin e raporteve të rregullta vjetore dhe atyre të jashtëzakonshme sipas kërkesës nga Ministria ose Kuvendi i Odës e në veçanti kur gjen shkelje të Statutit, akteve dhe vendimeve tjera të organeve të Odës;
 - 3.3. Mbikëqyrjen e veprimtarisë financiare të Odës dhe fondeve të saj, dhe
 - 3.4. Mbikëqyrjen e punës së organeve të Odës.
4. Kuvendi i Odës mund të autorizoj Komisionin Mbikëqyrës për kryerjen e aktiviteteve tjera të mbikëqyrjes nga ato të përcaktuara në paragrafin 3.
5. Për zbatimin e kompetencave dhe përgjegjësi të veta, Komisioni Mbikëqyrës ka të drejtë të kërkoj dhe të ketë qasje në informata dhe dokumente nga çilido organ i Odës.
6. Anëtari i Komisionit Mbikëqyrës nuk mund të jetë pjesë e organeve tjera të Odës, përveç Kuvendit.

7. Takimet e Komisionit Mbikëqyrës i flon dhe kryeson Kryesuesi i Komisionit.
8. Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës të zgjedhur nga Kuvendi i Odës, mund të shkarkohen nga Kuvendi i Odës. Anëtari i caktuar nga Ministria në Komision Mbikëqyrës mund të shkarkohet nga Ministria.
9. Mënyra e punës së Komisionit Mbikëqyrës përcaktohet në mënyrë më të detajuar me Rregullore të brendshme të punës të miratuar nga Komisioni.
10. Kompetencat e Komisionit Mbikëqyrës pas themelimit të Odës dhe gjatë periudhës së përkohshme të saj, i ushtron Komisioni i Ministrisë për Themelimin e Odës.

Neni 23

Zgjedhja, përbërja dhe mandati i Bordit Drejtues të Odës

1. Bordi Drejtues përbëhet nga gjithsej tetë (8) anëtarë, prej të cilëve shtatë (7) anëtarë i zgjedh Kuvendi nga anëtarët e vet dhe Drejtori Ekzekutiv i Odës i cili është anëtar pa të drejtë vote.
2. Bordi Drejtues kryesohet nga Kryetari i Odës.
3. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues, përveç Drejtorit Ekzekutiv, është tre (3) vjet pa të drejtë rizgjedhje.
4. Mbledhjet e Bordit Drejtues mbahen sipas nevojës dhe kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit me të drejtë vote.
5. Vendimet e Bordit Drejtues merren me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Bordit, me të drejtë vote. Gjatë mbledhjeve mbahen procesverbale të cilat janë të qasshme për anëtarësinë e Odës.
6. Bazuar nga numri i anëtarëve të Kuvendit, përfaqësimi i anëtarëve të Bordit Drejtues caktohet sipas profileve të ndryshme në mënyrë proporcionale.

Neni 24

Kompetencat dhe mënyra e punës së Bordit Drejtues

1. Bordi Drejtues është kompetent dhe përgjegjës për:
 - 1.1. Zgjedhjen e Kryetarit të Odës nga radha e anëtarëve të vet;
 - 1.2. Themelimin e Komisionit Vlerësues dhe Komisioneve të tjera sipas Ligjit në fuqi;

- 1.3. Hartimin e Statutit të Odës, Kodit Etik dhe të Sjelljes Profesionale të Odës, Rregullores për procedurën disiplinore, rregullave dhe procedurave të ankesës si dhe hartimin e akteve të tjera të Odës siç parashihet me Ligjin në fuqi dhe me aktet e përgjithshme të Odës;
- 1.4. Lëshimin dhe marrjen e vulës dhe kartelës identifikuese të inxhinierëve të licencuar;
- 1.5. Propozimin e vendimeve për çështjet për të cilat vendosë Kuvendi;
- 1.6. Zbatimin e vendimeve dhe akteve tjera të Kuvendit;
- 1.7. Mbikëqyrjen e standardeve të punës së anëtarëve të licencuar sipas detyrës zyrtare, të përcaktuara me aktet e Odës;
- 1.8. Përgatitjen e buxhetit vjetor të Odës dhe propozimit për miratim në Kuvend, në përputhje me kufizimet dhe detyrimet gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës;
- 1.9. Kontabilitetin financiar të Odës;
- 1.10. Përgatitjen e raporteve përkatëse për Kuvendin lidhur me shpenzimin e buxhetit;
- 1.11. Përgatitjen dhe miratimin e programit për edukimin e vazhdueshëm të anëtarëve të licencuar të Odës;
- 1.12. Thirrjen e mbledhjeve dhe propozimin e mbajtjes së zgjedhjeve në Kuvend;
- 1.13. Zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv dhe punonjësve të administratës me konkurs të hapur në pajtim me këtë Statut, si dhe pezullimin apo shkarkimin e tyre;
- 1.14. Miratimin e Programit vjetor të Odës;
- 1.15. Përpilimin e raportit vjetor për punën e Odës;
- 1.16. Dhënien e opinionit për ligjet dhe aktet nënligjore në fushën e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, mbrojtjes së mjedisit dhe fushave tjera që ndërlidhen me punën e inxhinierit, si dhe për projektligjet dhe projektaktet nënligjore, apo propozimin e dispozitave ligjore përkatëse;
- 1.17. Vendosjen për lartësinë e kompensimit për shërbimet që ofrohen nga Oda, përjashtimisht atyre të përcaktuara me rregulloren përkatëse për taksat dhe tarifat;
- 1.18. Vendosjen për ndarjen e çmimeve dhe mirënjohjeve për anëtarët e Odës;

1.19. Themelimin e komisioneve për çështje në kompetencë të Bordit, si dhe grupeve punuese, këshillave profesional dhe grupeve të ekspertëve, si dhe emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të tyre;

1.20. Vendosjen për çështjet tjera të cilat janë të përcaktuara me këtë Statut dhe aktet e përgjithshme të Odës, dhe

1.21. Vendosjen për çështjet të cilat nuk janë në kompetencë të organeve të tjera të Odës.

2. Bordi Drejtues i përgjigjet Kuvendit të Odës.

3. Mënyra e punës së Bordit Drejtues përcaktohet në mënyrë më të detajuar me Rregullore të brendshme të punës të miratuar nga Bordi.

Neni 25

Komisioni Disiplinor

1. Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Odës.

2. Komisioni Disiplinor zbaton procedurën disiplinore për shqiptimin dhe zbatimin e masave disiplinore ndaj anëtarit të licencuar në pajtim me Ligjin në fuqi dhe rregulloren përkatëse për procedurën disiplinore për anëtarët e Odës.

3. Komisioni Disiplinor në veçanti është përgjegjës për:

3.1. Shqyrtimin dhe vendosjen për propozimin për fillimin e procedurës disiplinore;

3.2. Shqyrtimin administrativ gjatë procedurës disiplinore;

3.3. Marrjen e vendimit për përgjegjësinë disiplinore të inxhinierit;

3.4. Shqiptimin dhe zbatimin e masave disiplinore, dhe

3.5. Shqyrtimin fillestar të ankesave ndaj vendimeve disiplinore, para se ato të kalojnë për shqyrtim te Komisioni i Ankesave.

4. Mandati i Komisionit Disiplinor është tre (3) vjet pa të drejtë rizgjedhje.

5. Komisioni Disiplinor i përgjigjet Kuvendit të Odës.

Neni 26
Komisioni i Ankesave

1. Komisioni i Ankesave përbëhet nga tre (3) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Odës.
2. Komisioni i Ankesave është organ i shkallës së dytë për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të komisioneve dhe organeve përkatëse të Odës dhe marrjen e vendimeve për këto ankesa.
3. Komisioni zhvillon procedurën administrative nga paragrafi 2 në përputhje me aktet e përgjithshme të Odës dhe legjislacionin në fuqi.
4. Vendimi i Komisionit për Ankesa është përfundimtar. Pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit të Ankesave, mund t'i drejtohet gjykatës kompetente.
5. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Ankesave është tre (3) vjet pa të drejtë rizgjedhje.
6. Komisioni i Ankesave i përgjigjet Kuvendit të Odës.

Neni 27
Komisioni Vlerësues dhe komisionet tjera

1. Bordi Drejtues i Odës themelon Komisionin Vlerësues i cili do të jetë përgjegjës për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për aplikimet për licencim e inxhinierëve.
2. Bordi Drejtues mund të themelojë Komisione të tjera për përmbushjen e përgjegjësisë të Bordit Drejtues të përcaktuara sipas Ligjit në fuqi dhe këtij Statuti.
3. Komisioni Vlerësues dhe Komisionet tjera të përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni do të përbëhen nga anëtarët e Bordit Drejtues. Për shërbimin në Komisionin Vlerësues dhe Komisionet tjera të Bordit nuk lejohet kompensim shtesë përveç kompensimit të rregullt që e marrin anëtarët për shërbimin e tyre si anëtar të Bordit të Drejtues.
4. Kryesuesi i Komisionit caktohet me vendimin për themelimin nga Bordi Drejtues. Kryesuesi është përgjegjës për thirrjen e takimeve të Komisionit dhe udhëheqjen e tyre.
5. Komisionet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij Neni për punën e tyre i raportojnë Bordit Drejtues.
6. Organizimi dhe puna e Komisionit Vlerësues përcaktohet me rregulloret përkatëse për licencimin e inxhinierëve, ndërsa e komisioneve tjera sipas këtij Neni, me vendimin për themelimin e tyre.

Neni 28
Mandati i anëtarëve në organet e Odës

1. Mandati i anëtarëve në organet e Odës përcaktohet me Ligjin në fuqi, këtë Statut dhe aktet tjera përkatëse të Odës.
2. Mandati i anëtarit të organit të Odës përfundon me:
 - 2.1. zgjedhjen e anëtarit të ri në organin përkatës;
 - 2.2. shkarkimin nga organi që e ka zgjedhur atë;
 - 2.3. revokimin e anëtarësisë në Odë;
 - 2.4. dënimin për vepër penale;
 - 2.5. dorëheqje, ose
 - 2.6. vdekje.
3. Me vendimin për pezullimin e licencës, anëtarit të licencuar i pezullohet edhe mandati në cilindo organ të Odës.
4. Shkarkimi për anëtarin e organit të Odës nga Kuvendi bëhet me mocion të propozuar nga 1/3 e anëtarëve të rregullt të Odës. Shkarkimi i anëtarit të organit të Odës mund të bëhet edhe për arsye të shkeljes së Statutit të Odës nga anëtari ose për arsye të neglizhencës apo mos efikasitetit të punës së tij.
5. Në rast të përfundimit të mandatit të anëtarit të organit të Odës, organi që e ka zgjedhur atë, e zgjedh anëtarin e ri në mbledhjen e radhës. Anëtari i ri zgjidhët me mandat të plotë.
6. Zgjedhja në pozitën e kryetarit të një organi, nuk e zgjat mandatin e anëtarit të zgjedhur në atë organ.
7. Në rast të dorëheqjes së anëtarit nga organi i Odës, ky anëtar vazhdon të kryej detyrat deri në zgjedhjen e anëtarit të ri.
8. Procedura dhe mënyra e zgjedhjes së organeve të Odës në Kuvend, mund të përcaktohet në mënyrë më të detajuar me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Neni 29
Drejtori Ekzekutiv dhe Administrata

1. Drejtori Ekzekutiv është zyrtari kryesor administrativ i Odës që udhëheq me Administratën e Odës dhe siguron funksionimin e rregullt dhe të vazhdueshëm të Odës.
2. Mandati i Drejtorit Ekzekutiv është katër (4) vjet me mundësi të vazhdimit.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv të Odës janë:
 - 3.1. udhëheq Administratën e Odës;
 - 3.2. pjesëmarrja në mbledhjet e Bordit Drejtues dhe të Kuvendit të Odës;
 - 3.3. pranimi dhe menaxhimi i korrespondencës së Odës;
 - 3.4. përkujdesja për përditësimin e regjistrave të Odës në përputhje me aktet përkatëse të Odës;
 - 3.5. përkujdesja për Vulën e Odës, të gjitha librat, dokumentet, regjistrat, korrespondencat, kontratat dhe dokumentet tjera që i përkasin Odës;
 - 3.6. përkujdesja për pronën e Odës dhe sigurimi që mjetet e grumbulluara të Odës mbliidhen dhe depozitohen në mënyrë të rregullt;
 - 3.7. ofrimi i informacioneve dhe raporteve sipas kërkesës nga Bordi Drejtues;
 - 3.8. kryerja e të gjitha detyrave të përditshme të menaxhimit dhe administrimit të zyrave të Odës, dhe
 - 3.9. kryerja e detyrave të tjera të përcaktuara nga Bordi Drejtues.
4. Për punën e tij, Drejtori Ekzekutiv i përgjigjet Bordit Drejtues të Odës.
5. Administrata e Odës ofron mbështetje administrative dhe ligjore për organet dhe anëtarët e Odës.
6. Administrata e Odës në veçanti i përgjigjet kërkesave legjitime dhe nevojave të anëtarëve të Odës, si dhe mbështet kryerjen në mënyrë profesionale, cilësore dhe të përgjegjshme të detyrave të organeve të Odës të përcaktuara me Ligjin në fuqi, këtë Statut dhe aktet tjera të Odës.
7. Drejtori Ekzekutiv dhe punonjësit e Administratës së Odës rekrutohen nga Bordi Drejtues i Odës në bazë të konkursit të hapur publik, bazuar në parimet e meritokracisë dhe transparencës.

8. Marrëdhënia e punës së Drejtorit Ekzekutiv dhe punonjësve të Administratës përcaktohet sipas ligjit të punës në fuqi. Kuvendi i Odës mund të miratoj rregullore të veçanta për përcaktimin e aspekteve të veçanta të kësaj marrëdhënie të punës.

9. Bordi Drejtues i Odës mund të vendosë që detyrat e caktuara administrative dhe ligjore të Administratës së Odës të kryhen nga persona juridik ose fizik të jashtëm, të kontraktuar nga Oda.

10. Organizimi i Administratës së Odës, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive në kuadër të Administratës, si dhe sistematizimi i vendeve të punës, përcaktohet me Rregullore për organizimin e brendshëm të Odës që miratohet nga Kuvendi i Odës.

Neni 30

Kompensimi për shërbimin në organet e Odës dhe pagat e administratës

1. Kryetari, anëtarët e Bordit Drejtues dhe anëtarët e komisioneve tjera të Odës kompensohen për shërbimin e tyre në organet e Odës.

2. Drejtori Ekzekutiv dhe punonjësit e administratës marrin pagë për punën e tyre sipas përcaktimeve në kontratat përkatëse dhe buxhetin e Odës.

3. Kuvendi i Odës miraton Rregullore të veçantë për kompensimin dhe pagat e kategorive nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij Neni.

KAPITULLI VI

AKTET E PËRGJITHSHME TË ODËS

Neni 31

Aktet e përgjithshme të Odës

1. Aktet e përgjithshme të Odës janë Statuti, Kodi i Etikës dhe i Sjelljes Profesionale dhe Rregulloret.

2. Nismën për aktet e reja të përgjithshme të Odës dhe ndryshimin e akteve të përgjithshme në fuqi, përveç Bordit Drejtues, mund ta parashtroj Kryetari i Odës, Komisioni Mbikëqyrës ose së paku një e treta (1/3) e anëtarëve të rregullt të Odës.

3. Nisma nga paragrafi 2 i propozohet Bordit Drejtues, që zhvillon tutje procedurën e hartimit dhe propozimit për miratimin e aktit në Kuvend.

4. Aktet e përgjithshme të Odës hartohen nga Bordi Drejtues dhe i nënshtrohen procedurës së marrjes së pëlqimit nga Ministria, siç parashihet me Ligjin në fuqi.

5. Aktet e përgjithshme të Odës, duke përfshirë këtë Statut, miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të anëtarëve të rregullt të Odës që janë të pranishëm dhe që votojnë. Ndryshimet

në Statutin e Odës miratohen me 2/3 e anëtarëve të rregullt të Odës që janë të pranishëm dhe që votojnë.

KAPITULLI VII FINANCIMI I ODËS

Neni 32

Të hyrat vjetore dhe plotësuese të Odës

1. Oda i realizon të hyrat vetanake nga:
 - 1.1. Tarifa për anëtarësi vjetore;
 - 1.2. Taksa për licencim dhe rilicencim;
 - 1.3. Taksa për mbulimin e shpenzimeve për veprimet e ndërmarra;
 - 1.4. Gjjobat dhe shumatat e tjera të paguara gjatë procedurës disiplinore, dhe
 - 1.5. Donacionet e tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Të hyrat e Odës përdoren për:
 - 2.1. përfaqësimin dhe harmonizimin e interesave të përbashkëta të anëtarëve të Odës;
 - 2.2. zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të Odës dhe organeve të saj;
 - 2.3. edukimin e vazhdueshëm profesional të anëtarëve të Odës;
 - 2.4. kompensimin dhe pagesën e anëtarëve të organeve të Odës dhe administratës së Odës, siç përcaktohet me Ligjin në fuqi dhe këtë Statut;
 - 2.5. sigurimin e pajisjeve dhe kushteve të nevojshme për punë, dhe
 - 2.6. mbulimin e nevojave tjera të Odës në përputhje me Ligjin në fuqi, këtë Statut dhe aktet tjera të Odës.
3. Me të hyrat e Odës menaxhon Bordi Drejtues dhe Kryetari i Odës sipas përcaktimeve të këtij Statuti, në përputhje me kufizimet dhe detyrimet gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës.
4. Lista e taksave dhe tarifave si dhe mënyra e pagesës së tyre përcaktohet me Rregulloren për taksat dhe tarifat e Odës.

5. Të gjitha taksat dhe tarifat e përcaktuara me Rregulloren e Odës sipas paragrafit 4 të këtij neni vendosen duke respektuar parimin e mbulimit të shpenzimeve administrative për shërbimet e ofruara nga Oda.

Neni 33 **Buxheti i Odës**

1. Të hyrat dhe shpenzimet e parashikuara të Odës përbëjnë Buxhetin vjetor të Odës, që propozohet nga Bordi Drejtues dhe miratohet nga Kuvendi i Odës.
2. Buxheti i Odës miratohet më së largu deri në fund të vitit për vitin vijues.
3. Në rast të mos aprovimit të Buxhetit të Odës sipas paragrafit 2, Kuvendi i Odës miraton vendimin për financimin e përkohshëm të aktiviteteve të Odës në tre mujorin e parë të vitit vijues.
4. Buxheti i Odës synon arritjen e objektivave dhe qëllimeve legjitime të Odës, si dhe menaxhohet duke u bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe raportimit, vlerës për para, kontrollit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm.
5. Oda i nënshtrohet auditimit në përputhje me dispozitat ligjore.
6. Buxheti i Odës gjatë periudhës së përkohshme të funksionimit të Odës i nënshtrohet kufizimeve dhe detyrimeve të përcaktuara me Ligjin në fuqi. Ekzekutimi i Buxhetit të Odës gjatë periudhës së përkohshme autorizohet nga Komisioni i Ministrisë për Themelimin e Odës.

KAPITULLI VII **SISTEMI ELEKTRONIK DHE FAQJA ELEKTRONIKE E ODËS**

Neni 34 **Sistemi Elektronik i Odës**

1. Oda ka Sistemin Elektronik që përdoret për procedurën e licencimit, disiplinimit, edukimit të vazhdueshëm profesional, organizimit të mbledhjeve të Kuvendit dhe organeve tjera të Odës, si dhe procedurave e çështjeve tjera përkatëse për funksionimin e Odës.
2. Deri në funksionalizimit e Sistemit Elektronik të Odës, procedurat administrative të Odës zbatohen përmes dokumenteve fizike.

Neni 35 **Uebfaqja elektronike e Odës**

1. Oda ka uebfaqen elektronike që shërben për publikimin e akteve dhe regjistrave të Odës siç përcaktohet me Ligjin në fuqi dhe këtë Statut, si dhe informimin e anëtarëve të Odës dhe publikut për aktivitetet e Odës.

2. Në kuadër të uebfaqes elektronike publikohet buletini i rregullt i Odës.

KAPITULLI IX DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 36

Periudha e përkohshme e funksionimit të Odës

Oda i nënshtrohet kufizimeve dhe detyrimeve të caktuara gjatë kohës së funksionimit të periudhës së përkohshme të Odës, siç përcaktohet me Ligjin në fuqi.

Neni 37

Mbështetja për Bordin Drejtues të Odës

Sekretaria e Komisionit Ministror për Themelimin të Odës mbështet Bordin Drejtues të Odës deri në miratimin e Rregullores për organizim të brendshëm të Odës dhe emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Odës.

Neni 38

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Odës dhe publikohet në faqen elektronike të Odës.

Arsim Rapuca



Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës